



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 1, datë 29.01.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”( Ora 10<sup>15</sup> )

Marrin pjesë :

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1.Simo Petromilo    | 23.Vjola Xhafaj      |
| 2.Rajmonda Zoto     | 24.Eneida Vera       |
| 3.Frosina Qyrdeti   | 25.Elca Bezhani      |
| 4.Liri Dëma         | 26.Shkëlqim Leskaj   |
| 5.Anxhela Shenaj    | 27.Alta Haluci       |
| 6.Gjergji Nika      | 28.Ledja Shollaj     |
| 7.Anisa Ceno        | 29.Illir Aliaj       |
| 8.Edison Kapaj      | 30.Brikena Sika      |
| 9.Myzafer Elezi     | 31.Refie Laze        |
| 10.Vullnet Bilbilaj | 32.Atird Hoxha       |
| 11.Edlira Kapllanaj | 33.Englantina Imeraj |
| 12.Jerina Dervishaj | 34.Simbol Pazaj      |
| 13.Endri Hyseni     | 35.Brikena Puka      |
| 14.Lorel Canaj      | 36.Elpiniqi Mërkuri  |
| 15.Ervis Moçka      | 37.Grigor Dede       |
| 16.Geron Gunbardhi  | 38.Liljana Breshani  |
| 17.Evis Allushi     | 39.Eglantina Aliaj   |
| 18.Sokol Kushta     | 40.Marsela Dashi     |
| 19.Roland Strakosha | 41.Arjan Isufi       |
| 20.Besmir Brahimi   | 42.Ardian Musta      |
| 21.Klodian Xhyheri  | 43.Gëzim Çapoj       |
| 22.Arsen Belaj      | 44.Briseida Çakërri  |

Mungojnë :

- 1.Aurora Qarri
- 2.Mujo Shakaj
- 3.Eda Begaj
- 4.Bujar Osmënaj
- 5.Dikens Bushaj
- 6.Erëmal Arapi
- 7.Novrus Rrokaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/1, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes të gjithëve !

Vijojmë me shprehjen e ligjshmërisë për vendimet Nr 97÷103, datë 29.12.2023(lexon shkresën e ardhur nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë ), ku të gjithë vendimet vlerësohen të ligjshëm. Kemi miratimin e procesverbalit të fundit të mbledhjes së këshillit, datë 29.12.2023.

E hedhim në votë.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Kalojmë në rendin e ditës. Sot ka ardhur një projektvendim, për miratimin e tavanëve përgatitorë për 2025÷2027, për të cilin nuk jeni lajmëruar, ndërsa për projektvendimin për taksat dhe tarifat e shërbimit funeral, jeni lajmëruar. Projektvendimi për tavanët është urgjent .

Z.Kozma Mali – Kemi përgatitur një projektvendim për tavanët përgatitorë, për 2025÷2027, i cili është përgatitur në vijimësi të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025÷2027. Është bërë parashikimi i të ardhurave për vitet 2025÷2027, bazuar në të ardhurat dhe realizimet e viteve 2022,2023,2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mos vazhdoni me relacionin. Pse është urgjent.

Z.Kozma Mali – Na duhet, është urgjent, pasi në muajin mars duhet të përgatisim tavanët për vitet 2025÷2027.

Znj.Elpinqi Mërkuri – 5 minuta pushim, të mblidhen kryetarët e grupeve.

Z.Klodian Xhyheri – Pse tani ?

Z.Daut Zëraj – Është thjesht çështje procedure.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Jeni dakort ta shtojmë në rendin e ditës?

Pra, ky projektvendim dhe, ai i taksave dhe tarifave për shërbimin funeral, ti shtojmë në rend dite?

Votojmë rendin e ditës.

Të gjithë pro.

Miratohet rendi i ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 1/2, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 , të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike, nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën, si dhe nga fondet e buxhetit vendor”.

Znj.Irena Stasa – Si zakonisht , përveç dy projektvendimeve që paraqet drejtoria jonë, sot kemi dhe projektvendimin për miratimin e kritereve të ndihmës.

Do lexoj projektvendimin me disa ndryshime në bazën ligjore...(lexon projektvendimin) mbi kriteret e dhënies së ndihmës nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor. ...

Ndër të tjera...fëmijët që qëndrojnë tek gjyshërit (për shkak të prindërve që janë emigrantë) ..Kjo është një nga pikat shtesë..

Çdo person ka dosjen me dokumentat përkatëse .

Z.Endri Hyseni – Ky projektvendim u diskutua në Komisionin Juridik. Projektvendimi i paraqitur ka pësuar disa ndryshime si në formë dhe në përmbajtje. Janë shtuar disa kritere për përmirësim....Janë shtuar pikat a,b,c...Me propozimet e bëra në mbledhjen e Komisionit Juridik, me ndryshimet në formë dhe përmbajtje, mendoj ta kalojmë për miratim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votë.

Votohet.

Pro – 40 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 1/3, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin dhjetor 2023”.

Z.Atird Hoxha – Relatojnë kryetarët e komisioneve, pastaj debatet., për procedurë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Më tepër për prezantimin dhe për qytetarët.

Z.Illir Aliaj – Le të kalojë projektvendimi. Jemi pro.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim pikën 2.

Të gjithë pro.

Pro – 41 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/4, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin dhjetor 2023”.

E kalojmë në votë. Votohet.

Pro – 41 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/5, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së z.Aleksandër Kamberaj,z.Bardhyl Meli dhe z.Imer Metaj,dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Z.Aulon Spaho – Drejtoria e Mbrojtjes Civile vjen me këtë projektvendim, me djegien e 3 banesave të qytetarëve, Aleksandër Kamberaj, Bardhyl Meli dhe Imer Metaj.  
Kërkojmë nga këshilli miratimin e vlerës financiare, për tu ardhur në ndihmë këtyre qytetarëve.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E hedhim në votë.

Votohet.

Pro – 41 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal

Nr 1/6, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës , miratimi i projektvendimit “Për krijimin e Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendor të Nderit në Bashkinë Vlorë”.  
Nga administrata.

Z.Dorian Demiri – Baza ligjore ku jemi mbështetur për këtë projektvendim është ligji Nr 112/3013 “Për deklaratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt e nderit vendorë në Republikën e Shqipërisë “.

Ky komision bazuar në ligjin e mësipërm , kalon në këshillin bashkiak për miratim. Përbëhet prej 5 anëtarësh , ku 4 janë nga fusha të ndryshme dhe 1 punonjës i administratës.

Z.Endri Hyseni – Edhe ky projektvendim u diskutua në Komisionin Juridik,dhe me propozim prej njërit nga anëtarët , kemi miratuar ndryshim në përbërje, por ky i fundit ka bërë një kërkesë dhe mbetet në komision. E miratojmë pa ndryshime, me këtë përbërje .

Znj.Alta Haluci – E vlerësoj miratimin për ngritjen e këtij komisioni, pasi është një detyrim. Dua të them , që kemi shumë probleme me komisionit, por propozimet dhe procedurat deri tani, kanë qenë të jshtëligjshme. Kemi mjaft personalitete dhe, jo ti vendosni apriori.

Duhet të jeni shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e këtij komisioni, si për emërtimet e rrugëve ...  
Ju jeni shumë e re zonja kryetare.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nuk është firmosur nga mua, nuk është projektvendim nga këshilli. U ngrit drejtori përkatës.

Znj.Alta Haluci – Tani...ju keni bërë një listë. Kam lexuar rregulloren, ligjin ..Nga opozita zoti Agron Shehaj, është propozuar dhe e keni hequr nga lista.

Është historian, është profesor Bardhosh Gaçe, është historian, është studiues, të jemi krenarë. Zoti Kreshnik Çipi, ish deputet, është emër .Dëgjova për ish prefektin e Gjirokastrës. Duhet vendosur emra, jo vetëm njerëz të mirë. Ne kemi shumë emra që duheshin vendosur në këtë komision, emra që i duhen Vlorës.Opozita prandaj është, edhe ne japim opinione. Më kot mblidhen kryetarët e grupeve ?

Po them disa emra. Mendojeni mirë krijimin e këtij komisioni.

Në fushën e mjeksisë - Remzi Haxhiu,.. Ago Nezha ,janë personalitete, e plot emra të tjerë.

Pra, ka vlonjatë të majtë e të djathtë. Kush e hoqi emrin e zotit Agron. Njoh që në Vlorë ka më shumë emra dinjitozë dhe personalitete.

Faleminderit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Për të qenë e qartë. Është propozim nga drejtoria juridike. Ne propozojmë, por projektvendimin e bën administrata. Është e vërtetë që nga kryetari i grupit ka ardhur ky propozim dhe , e vlerësoj. Unë qëndroj në çdo komision, unë nuk kam asnjë përgjegjësi.

Z.Ervis Moçka – Jam shumë dakort me emrat që përmendi zonja.Do ishte mirë që dhe administrata të ishte këshilluar në lidhje me këto personalitete....Nuk është e udhës që të hiqen dhe të vihen të tjerë.

Z.Klodian Xhyheri – Ligji Nr 112/3013, neni 17, lexon... përbëhet prej 5 anëtarë , 3 plus 2 të jashtëm..Rregulloren e këshillit të bashkisë, neni 48..mbështetur në VKM nr 861 dhe Ligjin 112...lexon (3 këshilltarë plus 2 të jashtëm ). Unë nuk shikoj të jetë zbatuar neni 17, i ligjit 112...Neni 40 ..i referohemi nenit përkatës të rregullores..Dhe ne zbatojmë këtë rregullore, për çdo hap duhet të mblidhemi dhe të diskutojmë. Nuk shikoj asnjë pikë të këtij neni. Të zbatohen nenet përkatëse.

Z.Daut Zëraj – Administrata ka dashur gjithpërfshirje.

Z.Klodian Xhyheri - Në kryesinë e dy mbledhjeve të mëparshme kam propozuar.Nëqoftëse, e keni vendosur...zbatoni ligjin.

Z.Ermal Dredha – Gjithpërfshirje, flasim dhe për fushat që ata mbulojnë...Zotin Çipi,sportist, jo vetëm historianë...Nuk mund të vendosim 30 vetë, 5 është komisioni. Edhe zoti Sokol është intelektual,është pjesë e administratës, i përgatitur. Gjithsesi , këto komisione, vitin tjetër prapë do zgjidhen. Nuk mund të vëmë kurrësesi peshoren, nuk ka qoka. Kanë vlerat e tyre në profilet e tyre.Të gjithë kanë kontributet e tyre në qytet.

Z.Klodian Xhyheri – Nuk i hyjmë debatit me emra. Të zbatohet ose ligji, ose rregullorja. Të zbatojmë ligjin..Ju jeni për gjithpërfshirës...Pra, ne propozojmë dhe ju vendosni emra të tjerë...Mos na merrni më mendim.

Z.Ermal Dredha – Pra, si doni, kush të hiqet dhe kush të vihet ?

Z.Klodian Xhyheri – Ne diskutuam.

Z.Ermal Dredha – Kemi respekt për të gjithë, janë të gjithë të vlerësuar, nuk janë qoka.

Është procedurë. Ka plot emra. Propozoni...Doni ta shtyjme ?..Por të bëhet ky debat kaq i gjatë .

Z.Geron Gunbardhi – Alta dhe Klodi, e kanë ngritur në parim. Kot e kaluat në emra personalë.

Z.Ermal Dredha – Nuk e lejon ligji më shumë emra. Po dal mbi komisionin,doni ta shtyjme për mbledhjen tjetër, që të diskutoni ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – Do merrni 5 minuta pushim.

Z.Ermal Dredha – Na sillni propozimet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – A mund të shtohen 2 emra, drejtori juridik ?

Z.Dorian Demiri – Më mirë të kishim, 4plus 1 nga administrata...prandaj e sjellim në këshill

Znj.Elpinqi Mërkuri – Dëshironi të shtojmë 2 emra në këtë projektvendim ?

Zoti Moçka, çfarë propozoni.

Apo ta shtyjme për mbledhjen tjetër .

Z.Gëzim Çapoj – Qyteti ka plot personalitete. Meqenëse, kanë ardhur këta 5 emra, le të shtohen dhe dy, mos të shtyhet më. Mos të zgjatet më. Kështu do jetë dhe mbledhjen tjetër.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kthen prefekti...Meqenëse jeni dakort të shtohen dy emra...

vendimi është i këshillit.

Z.Illir Aliaj – Në lidhje me këtë projektvendim , shkelim ligjin dhe rregulloren, për të shtuar dy emra. Hidhe në votim për ta shtyrë..Edhë këta emra janë figura ...Menoj që, të hidhet në votim. Kush është dakort të shtyhet apo kështu siç është sot? Po, jo ta bëjmë me 7..Bëjmë shkelje tjetër .

Z.Ermal Dredha – Zoti Simo, si më i vjetri, na jepni një mendim.

Z.Simo Petromilo – Ky diskutim dhe në këshillin e kaluar ka patur të njëjtat diskutime dhe nuk është gjendur ghuha e përbashkët.

-Është marrë mendimi i këtyre personaliteteve?

-Duke qenë se, këta janë përzgjedhur nga fusha të ndryshme, mendoj le ta kalojmë sot.

Znj.Alta Haluci – Keni shkelur ligjin, nuk keni marrë parasysh propozimet. Janë personalitete edhe ata që janë edhe ata që do shtohen.

Z.Illir Aliaj – Unë jam i mendimit, hidhe në votim , kush është dakort ta shtyjme ose me ...

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kush është pro, të miratohet me këtë listë që është ?

Votohet.

Pro – 21vota

Kundër - 5vota

Abstenim - 1votë

Pa votuar 5 anëtarë.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/7, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri –Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, në lagjen “Kushtrimi “, tek ish-Frigoriferi, Vlorë”.

Z.Illir Aliaj – Ditën e enjte është mbledhur Komisioni i Shërbimeve.

Z.Atird Hoxha – Pra, kryetarët e komisioneve, pastaj administrata.

Z.Illir Aliaj – U mbledh Komisioni i Strehimit. Përhëndes zotin Gunbardhi që morri pjesë edhe, pse nuk ishte pjesë e komisionit. Në atë komision, nga administrata, ne si komisioni i kërkuam administratës gjithë dosjet e aplikantëve, - 208 dosje. Ishte volum pune, pamë gjithë procedurën dhe na rezultoi :

Nga 208 dosje – 134 të skualifikuar

-64 tejkalonin të ardhurat

-45 rifreskim dokumentacioni

-Për mungesë dokumentacioni, 7 emra. Dhe që ishin skualifikuar 19. Nga ZRPP , rezultonin me pronë.

Tek pjesa e përfituesve

-Garsoniere →4 + 5 në listë pritje

-1+1 → 26 + 1 në listë pritje

-2+1→41 + 1 në listë pritje

-3+1 →4 + 2 në listë pritje.

Pra, 75 fitues dhe 17 në listë pritje.Gjithësej 92.

Për të qenë në rregull me qytetarët , bëmë këtë procedurë. U përzgjedhën, u morrën lista e garsoniereve , nuk po i them emrat. U zgjedhën dosjet me numra, pra morrëm 2 dosje fituese dhe 2 në listë pritje. Me një ndryshim të vogël, i mungonte një dokument i vogël, por që nuk ngrinte peshë. Ishte respektuar sistemi i pikëzimit.

Për strukturën 1+1, përzgjedhëm 3 dosje fituese +2 dosje në listë pritje.

Ishin të gjitha në rregull.

Për strukturën 2+1, përzgjedhëm 2 dosje fituese dhe 3 dosje në listë pritje. Ishin në rregull.

Për strukturën 3+1, pati një debat për një person që është në burg, por familja e tij ishte fituese....  
Proçesi ishte në rregull.

-U morrën gjithë dosjet , me” tejkalim të ardhurash”...pamë 6 dosje , ku nga këta, të gjithë tejkalonin kufirin e të ardhurave.

-Nga “nuk kishin rifreskuar dokumentacionin “..u zgjodhën 5 dosje.

Ne bëmë një lloj transparence , jo me emra, por i zgjodhëm me numra.

Edhe zoti Geron dhe zoti Gjergji, ranë dakort me këtë skemë.

-2 dosje që kishin dalë nga ASHK.

Pati sygjërim nga ne si komision..Pamë familjen e zotit Krenar Agushi ..,thjesht nga neglizhenca e tij..por ai i plotëson kriteret, është familje vunerabël..Ne i propozojmë komisionit të bashkisë, të kontaktojë me personin dhe të futet në listë pritje, është komunitet rom.

U diskutua dhe një emër që të kalonte në listë pritje, por komisioni i bashkisë, nuk e pati mundësinë ta kalonte. Ne e miratuam. Ky projektvendim të kalojë për votim sot në këshill.

Z.Atird Hoxha – Një propozim...Neni 81..lexon..... ka karakter individual ...Pra, për të gjithë emrat sipas listës përfituese. Ky staf .. këtë projektvendim, Për çdo emër mund të bëhet votim nominal i fshehtë. ....

Mbi bazën e kësaj hiqen gjithë aludimet..Pra, kush e vendos atë që përfiton dhe atë që është në listë pritje. Pra, të votohet emër për emër.

Komisioni ka bërë një gabim..mbështetur në ligjin 22/2018, në nenin 48 të tij ka përcaktuar....lexon,

Ky komision si vlerë ka marrë si minimal fiskal...Thuhet vlera mesatare në treg ..i është referuar çmimit minimal fiskal dhe jo çmimit të tregut.Pra, çmimi nuk është 600..., pra sipas ligjit për këto familje që tejkalojnë të ardhurat ..

Ligji thotë..1/6..pra, duhet bërë dhe njëherë kjo listë.

Arsye tjetër që e kundërshtoj, përveç se do ti drejtohem prefektit por dhe prokurorisë , sepse në lista, janë emra me biznese fitimprurëse.

Unë mendoj që ky projektvendim duhet riparë. Edhe më parë është bërë votim i fshehtë.

Për procedurë.Këto banesa janë ndërtuar nga EKB, e cila bën dhe njëherë llogaritjen e të ardhurave, por që nuk mund ta përfitojnë pensionistët.

14% e vlerës duhet të parapaguhet në EKB. A i kanë këto të ardhura qytetarët që ti shlyejnë për një afat ...

Votimi , duhet të jetë nominal..Ta përfitojnë ata që gëzojnë statusin e të pastrehut dhe që kanë 4 vjet që sorollaten. Unë ju kërkoj ta rishikoni. Ka në listë persona me biznese. Ju kërkoj të tërhiqemi 10 minuta ...

Z.Ervis Moçka – E ndoqa kolegun. Bie dakort për disa gjëra, të shmangim çdo lloj abuzimi, për rastin që citoi zoti Hoxha, për bizneset . Të pastrohët lista. Të shihet si e ka vendosur administrata.

Administrata ka bërë një relacion...nga dokumentacioni që në fillim, nga aplikantët. Vërtetimet nga institucionet.

-A është bërë verifikimi ?

-A është marrë ndonjë deklaratë nga personat për çka kanë deklaruar, që nga të ardhurat etj...?

Nuk mund të lejojmë që në këto lista, ka nga ata që nuk u takon të përfitojnë.Kanë biznese dhe i heqin të drejtën atij që vërtet i takon ta marrë.

Përsa i përket votimit ...lexon ...,neni 81, është rast që sjell pasoja financiare. Po të behet votim nominal, kot që flasim për kriteret. Do ishte mirë që, për shqetësimin që ngriti zoti Hoxha

dhe shqetësimet tona , të dëgjojmë administratën.

Z.Atird Hoxha – Në rastet e fituesve , bazuar në sistemin e pikëzimit , pra dhe ata në listë priten ...si votohen..Është një procedurë , është votuar në mënyrë të fshehtë.

Përveç atyre 3 a 4 që kanë biznese ..unë do të vazhdoj në rrugë ligjore..

Pra, administrata duhet të konsultohet me ata persona.

Znj.Irena Toshkallari – Në lidhje me personat që nuk ju takon , me biznese..Nëse keni raste konkrete...Administrata është mbështetur në dokumentacionin e paraqitur.

Sa për vlerën, është vlera mesatare, e miratuar me VKM. Për këtë arsye , komisioni i është drejtuar EKB, ku vlera është 61.800 lekë/m2. VKM-ja, na jep këtë çmim.

Sa për votimin nominal..renditja është bërë në bazë të skemës së pikëzimit. Pra, si mund të hiqet një me pikë maksimale? Kriteret janë vendosur me VKB, me sistem pikëzimi.

Komisioni ka vlerësuar në bazë të skemës së pikëzimit..pra, nëqoftëse ka 40 pikë , sepse i meriton, s’kemi të drejtë ta heqim dhe të vëmë një tjetër.

Është bërë bazuar në sistemin e pikëzimit. Nëse keni emër konkret, na i thoni.

Z.Geron Gunbardhi – Administrata është për tu përgëzuar për punën e bërë.Ne bëjmë kontrole.Çfarë vumë re.., dosjet nuk kishin mangësi. Pikëzimi fillonte me 25 pikë, grupi sipas pikëzimit. Të gjithë jemi që, shtëpitë ti marrë ai që i takon.

E para, mendoj se ASHK që nuk ka sistem dixhitalizimi,, dhe ato që janë në proces legalizimi, dhe së dyti , vura re, dy pensionistë me tre fëmijë në emigracion ..., të gjithë pensionistët kanë nevojë të marrin strehim, me ndihmën e fëmijëve..

Ardhjen e dokumentave nga ASHK, por ka dhe që nuk e kanë marrë vesh , kanë dokumentacionin, e meritojnë.

Administrata me institucionet, duhet të jetë shumë e kujdesshme në marrjen e dokumentacionit..., ose ta kalojmë në mbledhjen tjetër.

Z.Ermal Dredha – Nuk po bëj ekspertizën. Të gjithë janë nevojtarë, siç ligji e parashikon. Idea është ..jam i qetë me veten, nuk kemi pas ndërhyrje nga jashtë . Tu tregojmë qytetarëve, janë 75 banesa, aplikimet janë të shumta. Proçesi është bërë transparent, ligji ka interpretim. Ky proçes ka 2vjet e gjysëm që mbahet peng. Të japim një shembull që, nisëm një proçes, s’ka pasur ndërhyrje nga jashtë. Flasin letrat. Janë parë të gjitha dhe sistemi i pikëzimit rigoroz, që është miratuar nga ju. Jam i vetmi që kam parë gjithë listën , nuk njoh njeri. Transparenca është, orientimi është i drejtë. Nëse është ndonjë rast abuzimi, kalon në përgjegjësi personale dhe më vonë penale.

Por, të paktën të biem dakort, të paktën të tregohemi të drejtë me aplikantët. Proçesi të bëhet në..

Z.Myzafer Elezi - Është pika më e rëndësishme për mbledhjen e sotme. Në parim , jam të përfitojnë të gjithë. Në Komisionin Juridik dhe Kryesi, jemi fokusuar në bazën ligjore si dhe fokusuar tek sistemi i pikëzimit. Ngre si problem, është punë voluminoze...Është një qytetarë që ka bërë një ankesë drejtuar kryetares së këshillit, kryetarit të bashkisë, zonja Arjola Sinani...Nuk është as politike. Çfarë kam konstatuar nga dokumentacioni i saj..Është 31 vjeç, e divorcuar, gjithë dokumentacioni në rregull..Tek kushtet ekonomike nuk janë përfshirë , pikëzimi , si familje e re. Pasi u pa gjithë materiali, qytetarja , duhet të jetë fituese.., të paktën të jetë në listën e pritjes.

Znj.Irena Toshkallari - Është dosje që rastësisht u pa nga komisioni. Nga sistemi i pikëzimit , meqenëse tejkalon të ardhurat dhe nuk futet. Zonja është sqaruar.

1/6 e të ardhurave vjetore,të ardhurat e saj i tejkalojnë ...Pra, meqenëse ato tejkalojnë të ardhurat ,

nuk vazhdon më tej. Të ardhurat vjetore 763.434 lekë .Vlera , krahasuar për 1+1; 6592 lekë. Kjo është nga komisioni, bazuar në ligj.

Z.Myzafer Elezi – Fakti që është e divorcuar, me një fëmijë, të hidhet në votim.

Z.Atird Hoxha - Nuk është futur në pikëzim, pasi tejkalon të ardhurat ..Minimali fiskal, për shtetin paguan taksën, është për efekte financiare, çmimi minimal fiskal .

Znj.Irena Toshkallari – Çmimi mesatar

Z.Atird Hoxha – Në ligjin “Për strehimin ..”

Z.Dorian Demiri – Ka një proces. ASHK i dërgon shkresë EKB dhe përcakton çmimet përkatëse. Në rastin konkret nuk e kemi . Në muajin korrik, vetëm në Tiranë ka ndryshuar. Çmimi 61.800 lekë

Z.Atird Hoxha – Ligji 22/2018

Znj.Irena Toshkallari – Vkreja mesatare, bazuar në VKM, ne kemi marrë vendim. Rastet konkretisht, i keni ju. Komisioni për rastet që plotësojnë kriteret ...

Z.Illir Aliaj –Ligji e ka 61.800.Sa e do ?

Z.Atird Hoxha – Nëqoftëse, e bën 1000euro/m2, do plotësohen dhe përfshihen në listë. Të ardhurat tejkalohe, sepse m2 e kanë llogaritur me 620m2.

Z.Grigor Dede – Ligji 48/2023 është fakt.

Z.Atird Hoxha – Meqenëse rasti i zonjës së divorcuar ...Ajo që ka marrë komisioni, është çmimi minimal fiskal.

Z.Grigor Dede – EKB , ju ka thënë me këtë çmim.

Z.Atird Hoxha – lexon ligjin...

Z.Ermal Dredha – E kemi shkresën që ka sjellë EKB. Le ta marrë përgjegjësinë EKB.

Z.Myzafer Elezi – Propozimi im është, të përfshihet në listë pritje, zonja Arjola Sinani, për 1+1.

Z.Illir Aliaj – E shikojmë këtë propozim. Si shqetësim e shoh të drejtë. Por në ato dosje që ne pamë , ishte rastësi dhe dosja e zonjës, por nuk mund të dalim kurrë nga kjo.

Kemi një rregull, të dyja këto kritere, ka dhe persona të tjerë që kanë tejkallim të pagave. U është rritur paga dhe kanë dalë nga sistemi. Po të ishte rritur dhe indeksi, kjo listë .....,nuk është një transaksion, kjo është një lloj ndihme. Ky proces, emër për emër, nuk duhet bërë.

Z.Atird Hoxha – Më vjen shumë keq. E pashë shkresën, nuk keni bërë kërkesë për çmim. EKB..lexon shkresën...nga EKB për çmimin 61.800, për përcaktimin e vlerës së taksimit.

Z.Ervis Moçka – Çështja që po diskutohet , është shumë teknike por dhe sensitive, pra , jo thjesht ngritje kartoni..

Po bëhet një debat, mbase dhe qytetarët s’mund të na ndjekin . Ky debat është teknik. Pra, të ngrihet një ekonomist ose financier, të na sqarojë dhe të jem i qartë për votimin.

Z.Gjergji Nika – Përsa i përket zotit Elezi, nuk jam dakort me propozimin. Proçedura është proçedurë, por që në muajin shkurt që çmimi i referencës do shkojë 82 ....lekë,në pallatin tjetër. Kemi diskutuar me zonjën Irena. Ka një mospërputhje midis bankës, pasi banka klasifikon ata me të ardhura të larta.

-Problematika kryesore.. brenda 60 ditëve.

A është penalizuar bashkia për vonesën me gjobë ?

Është listë e mbartur dhe kush e mban përgjegjësinë ? Nuk qëndron problemi tek dokumentacioni.

Pra, dua të di, A është penalizuar Bashkia Vlorë për këtë vonesë 3-vjeçare,.. ajo listë ose do skualifikohet.. Pra, A ka marrë ndonjë gjobë për 3-vjeçarin dhe kush e mban përgjegjësinë ?

Znj.Irena Toshkallari – Ndothemi përpara kritereve. Është çështje e ndjekur dhe në gjykatë.

Z.Dorian Demiri – Tek 11,5 milion lekë/reja gjobë, si pasojë e vonesës nga këshilli i mëparshëm.

Z.Grigor Dede – Ligji 48/2023, neni 21, pika 1 ,lexon...nuk merr parasysh rritjen e pagave dhe mos ndyshimin e çmimit 61.800.

Meraku kryesor, shkresa që i kanë nisur EKB dhe është vendosur ky çmim..Kriteri i 1/6 ...

Një aplikant për një garsonierë, fiton me pagën 400mijë lekë..,kurse me pagën 41 mijë lekë nuk e fiton dhe, ne këtë duhet të rregullojmë. Është një VKM dhe shkresa e EKB. Do ndërtohen dhe 5 godina të tjera.

Komisioni ka 2 muaj që po punon. Le ti hapim rrugën këtyre familjeve në nevojë dhe të vazhdojnë procedurat për apartamentet e tjerë.

Z.Ervis Moçka – Ligji, ..pika “dh”, lexon ....neni i ri përcakton dhe vlerën mesatare të banesave . Vlera mesatare nga EKB, jo më tregu, VKM neni 26/2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Meqenëse ju zoti Atird, jeni i pasqaruar, dërgoni një shkresë EKB për sqarim.

Z.Dorian Demiri – Nuk është shpronësim.

Z.Klodian Xhyheri – Komisioni, vërtetimin nga Kadastra, informacioni është i përditësuar.

Z.Dorian Demiri – Nga Sigurmiet shoqërore, ASHK dhe Drejtoria e Tatimeve, e kemi informacion zyrtar dhe, në përgjithësi nga ASHK, ka apo s’ka pronë, legalizim, transaksion.

Z.Klodian Xhyheri – Është i përditësuar, po apo jo ?

Znj.Irena Toshkallari – Për post informacionit nga qytetarët, ne e kemi marrë nga ASHK. Kemi dërguar shkresë në ASHK, përgjegjësini e mban institucioni.

Z.Klodian Xhyheri – Ka pretendentë në listë, që janë në proces legalizimi..Si i keni verifikuar ?

Znj.Irena Toshkallari – Ka pas raste nga ASHK, që janë në proces legalizimi. Individët në proces legalizimi, janë marrë në konsideratë ato raste kur janë prishur banesat për projekte.. Janë 19 raste.

Z.Klodian Xhyheri – keni pasur ndërhyrje nga këshilltarët e opozitës ?

Znj.Irena Toshkallari – Kryetari u shpreh shumë mirë. Nuk ka pas ndërhyrje as nga pozita as nga opozita.

Z.Ervis Moçka – U bë pyetje, u kthye përgjigje. Nëqoftëse, ka informacion që ka selektime..., të jetë transparent. Problemi është, interpretimi financiar. Nëqoftëse, ka ndonjë abuzim, le të mblidhen kryetarët e grupeve , flisni me emra konkretë. Të jemi sa më transparentë.

Z.Dorian Demiri – Nëqoftëse, keni emra, na i thoni.

Z.Atird Hoxha – A ka familje me biznese në listë ?

Z.Dorian Demiri - Të ardhurat ..ka 3 kritere ligji,.. të pasurit biznes , nuk të ndalon. Ka pas nga opozita ..

Z.Grigor Dede - Të rregullojmë ligjin, t’ia përcjellim rregullatorit.

Znj.Alta Haluci - Po diskutojmë për një çështje shumë delikate, 75 banesa janë. Për të diskutuar më tutje...Jam dakort për të gjithë ata që përfitojnë...Komisionit. Kam një emër. Është një zonjë , quhet Alma, ishte fituese në listën e parë dhe tani është në listë pritje.

Pse është hequr nga lista fituese, në listë pritje..Quhet Alma Hoxha. Nuk po futem në detaje. Të marrë kush e meriton. Për Almën, do të doja një sqarim.

Zonja Rajmonda Kashuri, është fituese..kishte emra që i njohim dhe që kanë dalë fitues. Për Almën doja ndonjë informacion ?

Znj.Irena Toshkallari – Zonja, nuk i është drejtuar Bashkisë Vlorë. Listat u shpallën për 5 ditë, ku mund të bëheshin ankesat, nuk është skualifikuar, por bazuar në ankesat që erdhën,



është në listë pritje.

Z.Myzafer Elezi – E trajtova pak më parë, për zonjën Arjola Sinani .

Z.Ermal Dredha – Vendimi kolegjal është mbi mua ..

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Kemi 2 propozime.Për zotin Agushi dhe zonjën Arjola, për në listë pritje. Propozimi i komisionit, emri i Krenarit, ishte. Të sqaroj diçka.

Propozimi i komisionit, zotit Agushi, i mungonte një dokument ..Ndajmë njëherë këtë gjë.

Z.Illir Aliaj – Emri i Krenar Agushit, është punonjës në ndërmarrjen komunale . Është një familje me bashkëshorten pa punë , ka dhe 4 persona të tjerë , janë pa shtëpi.

E pamë në komision dosjen. Mungonte dokumenti nga Hipoteka . E dimë të gjithë që s'ka shtëpi, ne vendosëm si komision që, ky rast të futet.

Edhe ky rast, emri i pedagoges , e pamë, tejkalonte të ardhurat, prandaj është skualifikuar . Të rishikohen.

Z.Gjergji Nika – Çfarë ne propozuam në komision ..Nëqoftëse, komisioni vendos diçka, administrata të na dëgjojë. Le ta vendosin. Pra, kur e vendosim ne, pse nuk e vendosni ju ?

Z,Ervis Moçka – Është çështje proceduriale . Në votim hidhet një me ndryshimin e komisionit dhe një i administratës.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Zoti Krenar ...Kur të kalojë ky propozim, do kalojë bashkë me emrin e zotit Krenar. Ndërsa për zonjën Anisa, propozimin e zotit Elezi, vendosni vetë .

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Votohet për zotin Krenar Agushi .

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Votohet propozimi për pedagogen.

Pro – 39 vota

Kundër – 1 votë

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Znj.Anxhela Shenaj – Sa për dijeni të qytetarëve, këto banesa janë jetike. Janë shumë nga ata që nuk kanë miq. Për ata që nuk e përfitojnë, nuk keni dhembshuri për ato familje që kanë nevojë...Kërkoj që të shtyhet për mbledhjen tjetër, të votohet emër për emër dhe të jenë të pranishëm aplikantët.

Znj.Edlira Kapllanaj – Këto nuk janë banesa sociale, janë banesa me kosto të ulët.

Këshilli i bashkisë, miratoi pikëzimin dhe dolëm me dy vendime kryesore, pra të kenë të ardhurat dhe të mos kenë pronë.

Komisioni i bashkisë, ka punuar. Vlen për tu admiruar dhe falënderuar puna e zonjës

Toshkallari dhe drejtorit juridik, zotit Dorian , duke mos llogaritur orët e vona, për ti dhënë fund orvatjeve të këtyre familjeve, për banesë.

Më në fund,përfunduan, falë punës së komisionit. Shpresoj që familjet të marrin çelsat. E kam ndjekur hap pas hapi këtë komision. Pas përfundimit të listës, u publikuan dhe u shpallën 5 ditë.

Të miratojmë këtë projektvendim, flas dhe në emër të përfituesve të komunitetit rom.

Z.Ervis Moçka – Ky diskutim ishte shumë për tu vlerësuar. Zonja është përfaqësuese e komunitetit , e zërit të qytetarit. Të kalojnë, në emër të kryetarëve të grupeve dhe mbyllim procesin.

Z.Atird Hoxha - Në fjalën time, kërkoja që, ky projektvendim të votohet fshehtazi. Nëqoftëse, ju do votoni hapur, në bllok, unë do ta abandonoj këtë këshill.

Ky këshill, ka kaluar të njëjtën procedurë, emër për emër. Ky projektvendim, neni 81 i rregullores së këshillit bashkiak, votimi i fshehtë , bëhet për aktet individuale.

Z.Klodian Xhyheri – Do të doja që, lista mos të ketë emra, të cilët kanë plotësuar kriteret formale. Do të doja listat që mos të ketë emra,që ..;

-Mos të kishte ndërhyrje

-Të cilët posedojnë banesë që janë në proces legalizimi

-që kanë një titull pronësie dhe presin të marrin , një tjetër.

Siç e tha dhe zoti Atird , në përputhje të ligjit, duhet ti votojmë në mënyrë të fshehtë.

Z.Geron Gunbardhi – Ky proces ka qenë i gjatë , gjithë këto vite. Prita të kishte më shumë debat nga pozita.

Do ishte mirë, që këto deklarata, të ishin noteriale .Banka do bëjë seleksionime.

Procedura nga administrata, vlen për tu përgëzuar , por që të ishte lënë pak më shumë kohë .

...Dokumentacioni, ishte shumë i saktë.

Z.Arsen Belaj - Më vjen keq që po silleni kështu.... EKB i jep banesat, ajo është me kosto të ulët. Ne kemi dëshirë ti ndihmojmë njerëzit në nevojë, por banka do ti skualifikojë . S'po ndajmë ne banesa . Të mos sillemi sikur ne, këshilli, jemi pronarë që ndajnë shtëpi.

Z.Gjergji Nika – Është shumë e rëndësishme që procesi të eci përpara. Penaliteti ka qenë 11,2milion për Bashkinë Vlorë, ka pallate të tjerë që po ndërtohen . Të vazhdojë procesi, të eci përpara. Vota ime është pro, që procesi të eci përpara.

Znj.Elca Bezhani – Problematika është kaq sensitive. Unë i vlerësoj, s'jemi as të majtë e as të djathtë për qytetarin. Edhe unë si zoti Atird, isha e shqetësuar por e kisha kuptuar ligjin si zoti Atird..

Kam marrë sqarime nga administrata. Vlerësoj punën e zonjës Drita, specialistes së strehimit, e cila ka vite që e ndjek procesin dhe, e ka ndjekur mirë. Ministria e Financave ja kalon EKB çmimin dhe çmimi i referencës 61.800 s'kualifikon mendimin tim dhe të zotit Atird.

Për votimin e fshehtë.., është sistemi i pikëzimit , është bërë një listim.

Ne nëqoftëse, kemi 10 familje, nuk mund ti kalojmë në votim një për një , pasi është sistemi i pikëzimit. Prandaj, s'jam dakort . Dhe unë kam marrë disa indicie , kam shkuar pranë administratës dhe kam marrë sqarimet e duhura. Puna e komisionit është bërë.

Duke parë anën teknike mnedoj ta votojmë.

Znj.Elpinijë Mërkuri – E hedhim në votë.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër -0 vota

Abstenim – 0 vota

10 anëtarë pa votuar.

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/8, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kemi 2 projektvendimet shitesë . Projektvendimi “Për miratimin e tavanëve përgatitorë për të ardhurat 2025 ÷ 2027 “. E hedhim në votim, relacionin që referoi zoti Kozma .

Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

12 pa votuar.

Miratohet.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/9, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në projektvendimin “Për një ndryshim në Vendimin Nr 96, datë 07.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024”.

Është menaxhuar më parë nga një kompani ky shërbim, e ka marrë bashkia.

Tarifat janë ulur.

E kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Pa votuar 12 anëtarë.

Miratohet.



---

REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr \_\_\_\_\_ prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

Procesverbal  
Nr 1/10, datë 29.01.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën “Mbi raportin statistikor të punës dhe vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë Vlorë , për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2023”.

Z.Daut Zëraj – Për datat e mbledhjes së komisioneve, është e domosdoshme të zgjedhin dhe sekretarët për të mbajtur procesverbalet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Tek pika “Të ndryshme “.

Ka njeri ndonjë pyetje ?

-Jo.

Atëherë , faleminderit për ditën e sotme.

Mirutakofshim në seancën e radhës.